FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Ekstra 15	Qershor	2004

AKTE TË PAPUBLIKUARA PËR SISTEMIN E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

Faqe

Vendim i KM nr.299, datë 4.7.1994	Për realizimin e projektit të sistemit të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme (SRPP) dhe sigurimin e mjediseve të regjistrimit.....	3
Vendim i KM nr.352, datë 3.5.1995	Për miratimin e certifikatave të pronësisë së pasurive të paluajtshme.....	3
Vendim i KM nr.303, datë 16.4.1996	Për çeljen dhe fillimin e punës së zyrave të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme në disa rrethe.....	13
Vendim i KM nr.94, datë 26.2.1997	Për srtukturën dhe organikën e zyrës qendrore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.....	13
Vendim i KM nr.281, datë 9.5.1998	Për një shtesë në vendimin e këshillit të ministrave nr.157, datë 26.2.1998 "Për fillimin e punës së zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme në disa rrethe".....	17
Vendim i KM nr.553, datë 28.8.1998	Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të shoqërive tregtare, të krijuara nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore.....	17
Vendim i KM nr.596, datë 21.9.1998	Për mbylljen e zyrave të hipotekave dhe për kalimin e veprimtarisë së tyre në zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme.....	18

V E N D I M
Nr.299, datë 4.7.1994

PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT TË SISTEMIT TË REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME (SRPP) DHE SIGURIMIN E MJEDISEVE TË REGJISTRIMIT

Më propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe të Ministrisë së Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Njësia e menaxhimit të projektit (NMP) për sistemin e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme (SRPP), në bashkëpunim me seksionet e kadastrës dhe urbanistikën në rreth dhe me kadastrën urbane të Bashkisë së Tiranës emëron koordinatorin e saj, i cili organizon dhe drejton punën për sistemin e regjistrimit të të gjitha pasurive të paluajtshme.

2. Pagesa e këtyre punonjësve bëhet nga njësia e menaxhimit të projektit (NMP) sipas kontratës individuale të punës.

3. Fondi i pagave të planifikuara nga këshilli i rrethit, që sot për sot merret nga këta punonjës, të përdoret për pajisje dhe meremetime të zyrave të kadastrës së rrethit.

4. Specialistët e tjerë që nuk janë në marrëdhënie pune me shtetin e që do të punojnë për realizimin e projektit, të paguhen nga NMP-ja sipas vëllimit të punës, në bazë të kontratës individuale të punës.

5. Dokumentacionet e pronësisë, të përcaktuara sipas ligjeve nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve" dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre, që sot për sot administrohen nga kadastrat bujqësore, urbane, hipotekat dhe ndërmarrjet komunale të banesave, të vihen gradualisht sipas kërkesës në dispozicion të koordinatorëve të projektit në rreth.

6. Këshillat e rretheve, në bashkëpunim me këshillat e bashkive dhe me Bashkinë për qytetin e Tiranës, të sigurojnë brenda muajit korrik të vitit 1994 mjediset e nevojshme prej 300 m^2 për zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, të cilat do të jenë bazat e unifikimit të zyrave të sotme të kadastrës dhe të hipotekës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

V E N D I M
Nr.352, datë 3.5.1995

PËR MIRATIMIN E CERTIFIKATAVE TË PRONËSISË SË PASURIVE TË PALUAJTSHME

Në mbështetje të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme”, të neneve 28 e 56, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e tipeve të certifikatave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, që do të lëshohen nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të rretheve të Republikës së Shqipërisë, sipas lidhjeve 1-15 që i bashkëngjiten këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryeregjistruesi i Pasurisë së Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

Lidhja nr.1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME

CERTIFIKATË
PËR VËRTETIM PRONËSIE

ZYRA E REGJISTRIMIT _____, zona kadastrale nr. _____
Numri i pasurisë _____, Vol, _____, Faqe _____
Adresa e pasurisë _____
Lloji i pasurisë _____
Sipërfaqja totale _____
Nga kjo: sa truall _____, Nga kjo: Sa ndërtesë _____
N.q.s. pallat: Kuota e pjesëmarrjes _____%

KJO CERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË:

Zoti (zotërinjtë) (Emri, atësia, mbiemri)	Pjesa	Adresa
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____

- është pronar i _____
- janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart _____
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi _____
- kufizimet e pasurisë janë: V. _____, L. _____, J._____, P._____

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me ligjin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me ligjin e regjistrimit të pasurisë të paluajtshme.
Data e lëshimit të certifikatës
_____

Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë _____ nr. _____

Lëshuesi i certifikatës

Regjistruesi

Lidhja nr.3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME

CERTIFIKATË
PËR DHËNIE ME QIRA

ZYRA E REGJISTRIMIT _____, zona kadastrale nr. _____
Numri i pasurisë _____, Vol, _____, Faqe _____
Adresa e pasurisë _____
Qiradhënësi (t) _____
Vlera e qirasë _____
Afati i dhënies me qira: _____

KJO CERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË:

Qiradhënësi (t) e mësipërm kanë dhënë me qira pasurinë e paluajtshme, sipas kushteve të kontratës nr. _____ datë _____ .

dhe që Zoti (zotërinjtë)
(Emri, atësia, mbiemri)

---
me adresë ---
është/ janë regjistruar si qiramarrës të pasurisë së mësipërme sipas tërë kushteve të regjistruara në kartelën përkatëse të kësaj pasurie në vol. _____, faqe. _____, në përputhje me ligjin e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme dhe të neneve përkatëse të Kodit Civil.

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me ligjin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me ligjin e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme. Data e lëshimit të certifikatës _____	Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë _____ nr. _____
Lëshuesi i certifikatës	Regjistruesi

Lidhja nr.4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME

CERTIFIKATË
PËR DHËNIE ME NËNQIRA

ZYRA E REGJISTRIMIT _____, zona kadastrale nr. _____
Numri i pasurisë _____, Vol, _____, Faqe _____
Adresa e pasurisë _____

KJO CERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË:

Zoti (zotërinjtë)
(Emri, atësia, mbiemri) Pjesa Adresa
_____ _____ _____
_____ _____ _____
_____ _____ _____
_____ _____ _____
_____ _____ _____
_____ _____ _____

I cili (të cilët) ka (kanë) marrë me qira nga
_____
pasurinë e mësipërme, kartela e së cilës ndodhet në vol. _____, faqe _____ dhe me pëlqimin e tij (tyre) kanë dhënë me nënqira këtë pasuri, sipas kushteve të kontratës nr. _____, datë _____.

Zotit (zotërinjve)
(Emri, atësia, mbiemri) Pjesa Adresa
_____ _____ _____
_____ _____ _____
_____ _____ _____
_____ _____ _____
_____ _____ _____

Kjo certifikatë lëshohet në përputhje me ligjin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me ligjin e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme.
Data e lëshimit të certifikatës
_____

Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë _____ nr. _____ .

Lëshuesi i certifikatës

Regjistruesi

Lidhja nr.5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME

CERTIFIKATË
PËR VËRTETIM HIPOTEKIMI TË PASURISË SË PALUAJTSHME

ZYRA E REGJISTRIMIT _____, zona kadastrale nr. _____
Numri i pasurisë _____, Vol, _____, Faqe _____
Adresa e pasurisë _____

KJO CERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË:

Zoti (zotërinjtë) (Emri, atësia, mbiemri)	Pjesa	Adresa
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____

është/ janë pronarë (bashkëpronarë sipas pjesëve si më lart) i (të) regjistruar në kartelën përkatëse të kësaj pasurie në vol. _____, faqe _____, në përputhje me ligjin e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme dhe për qëllim realizim detyrimi ka (kanë) hipotekuar tërë ose _____ pjesë të pasurisë (së) e (të) mësipërme në favor të _____, me aktin noterlial nr. _____, datë _____, garanci për realizimin e detyrimit ndaj personit (fizik/juridik) _____

sipas dokumentit përkatës që disponohet në dosje.

Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë _____, nr. _____.

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me ligjin e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme.
Data e lëshimit të certifikatës
_____

Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë _____ nr. _____ .

Lëshuesi i certifikatës

Regjistruesi

Lidhja nr.6

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME

CERTIFIKATË
PËR VËRTETIM HIPOTEKIMI LIGJOR TË PASURISË SË PALUAJTSHME

ZYRA E REGJISTRIMIT _____, zona kadastrale nr. _____
Numri i pasurisë _____, Vol, _____, Faqe _____
Adresa e pasurisë _____

KJO CERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË:

Zoti (zotërinjtë) (Emri, atësia, mbiemri)	Pjesa	Adresa
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____

ka (kanë) blerë pasurinë e mësipërme, kartela e të cilit ndodhet në vol. _____, faqe _____, sipas kontratës përkatëse nr. _____, datë _____ dhe ka (kanë) hipotekuar në interes ligjor të tërë pasurinë e mësipërme ose pjesën _____si garanci për të realizuar detyrimin e pagesës për një afat deri më datë _____, sipas dokumentit përkatës që disponohet në dosje.

Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë _____, nr. _____.

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me ligjin e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme.
Data e lëshimit të certifikatës

_____

Lëshuesi i certifikatës

Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) datë _____ nr. _____ .

Regjistruesi

Lidhja nr.9

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME

CERTIFIKATË
PËR VËRTETIM TITULLI “NË PËRDORIM”

ZYRA E REGJISTRIMIT _____, zona kadastrale nr. _____
Numri i pasurisë _____, Vol, _____, Faqe _____
Adresa e pasurisë _____

KJO CERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË:

Zoti (zotërinjtë) (Emri, atësia, mbiemri)	Pjesa	Adresa
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____

është (janë) i (të) regjistruar si përdorues i pasurisë së paluajtshme shtetërore të mësipërme, kartela e së cilit ndodhet në vol. _____, faqe _____.

Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë _____, nr. _____.

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me ligjin e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme.
Data e lëshimit të certifikatës
_____

Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë _____ nr. _____ .

Lëshuesi i certifikatës

Regjistruesi

Lidhja nr.13

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME

CERTIFIKATË
PËR VËRTETIM REGJISTRIMI SERVITUTI

ZYRA E REGJISTRIMIT _____, zona kadastrale nr. _____
Numri i pasurisë _____, Vol, _____, Faqe _____
Adresa e pasurisë _____

KJO CERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË:

Në kartelën vol. _____, faqe _____, të pasurisë së paluajtshme të mësipërme me pronar (e)

Zoti (zotërinjtë)

(Emri, atësia, mbiemri)	Pjesa	Adresa
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____

është regjistruar servitudi si më poshtë:

_____
_____
_____
_____
_____

në bazë të aktit noterial nr. ____, datë _____
ose
në bazë të vendimit gjyqësor nr. ____, datë _____
Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë _____, nr. _____.

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me ligjin e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme.
Data e lëshimit të certifikatës
_____

Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë _____ nr. _____ .

Lëshuesi i certifikatës

Regjistruesi

Lidhja nr.14

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME

CERTIFIKATË
PËR VËRTETIM TË MARRËVESHJES KUFIZUESE

ZYRA E REGJISTRIMIT _____, zona kadastrale nr. _____
Numri i pasurisë _____, Vol, _____, Faqe _____
Adresa e pasurisë _____

KJO CERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË:

Në kartelën vol. _____, faqe _____, të pasurisë së paluajtshme të mësipërme
me pronar (ë)
Zoti (zotërinjtë)
(Emri, atësia, mbiemri) Pjesa Adresa
_____ _____ _____
_____ _____ _____
_____ _____ _____
_____ _____ _____
_____ _____ _____
_____ _____ _____

është regjistruar një marrëveshje kufizuese, si më poshtë:

_____
_____
_____
_____
_____

në bazë të kërkesës së pronarit (eve) sipas dokumentit të paraqitur prej tij që ndodhet në zyrën e regjistrimit nr. _____, datë _____

Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë _____, nr. _____.

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me ligjin e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme.
Data e lëshimit të certifikatës
_____

Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë _____ nr. _____ .

Lëshuesi i certifikatës

Regjistruesi

Lidhja nr.15

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME

CERTIFIKATË
PËR VËRTETIM REGJISTRIMI TË KUFIZIMIT

ZYRA E REGJISTRIMIT _____, zona kadastrale nr. _____
Numri i pasurisë _____, Vol, _____, Faqe _____
Adresa e pasurisë _____

KJO CERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË:

Në kartelën vol. _____, faqe _____, të pasurisë së paluajtshme të mësipërme me pronar (e)

Zoti (zotërinjtë)

(Emri, atësia, mbiemri)	Pjesa	Adresa
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____

është regjistruar një kufizim si më poshtë:

_____
_____
_____
_____
_____

në bazë të urdhrit të lëshuar nga regjistruesi nr. ____, datë _____

Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë _____, nr. _____.

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me ligjin e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme.
Data e lëshimit të certifikatës
_____

Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë _____ nr. _____ .

Lëshuesi i certifikatës

Regjistruesi

V E N D I M
Nr.303, datë 16.4.1996

PËR ÇELJEN DHE FILLIMIN E PUNËS SË ZYRAVE TË REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME NË DISA RRETHE

Në mbështetje të neneve 56 dhe 57 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me propozimin e Kryeregjistruesit të Pasurisë së Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në rrethet Tiranë, Kavajë, Lushnjë dhe Gramsh me qendër në këto qytete çelet dhe fillon punën zyra e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme.
2. Ministria e Drejtësisë dhe Kryeregjistruesi i Pasurisë së Paluajtshme të marrin masat për transportimin, sistemimin dhe sigurimin e regjistrave të zyrave të hipotekës së këtyre rretheve pranë gjykatave të shkallës së parë, për të mbajtur të paprekura vlerat provuese e historike të tyre.
3. Personeli i hipotekave të këtyre rretheve do të kalojë brenda strukturës administrative të zyrave të regjistrimit me urdhër të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Kryeregjistruesit të Pasurisë së Paluajtshme.
4. Nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për çeljen dhe funksionimin e zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat do të hapen gjatë vitit 1996, jepen 20 milionë lekë për Kryeregjistruesin e Pasurisë së Paluajtshme: 13.4 milionë lekë për shpenzime operative dhe 6.6 milionë lekë për investime.
5. Për vitin 1996, të ardhurat që sigurohen në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të rretheve për shërbimet ose veprimtaritë që ato u ofrojnë të tretëve, 70 për qind përdoren nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe 30 për qind derdhen në Buxhetin e Shtetit.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Drejtësisë dhe Kryeregjistruesi i Pasurisë së Paluajtshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

V E N D I M
Nr.94, datë 26.2.1997

PËR SRTUKTURËN DHE ORGANIKËN E ZYRËS QENDRORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

Mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.469, datë 14.8.1995 "Për kompetencat për emërimin dhe largimin nga detyra të drejtorëve të drejtorive në ministri dhe institucione të tjera qendrore dhe për ndryshimet në strukturat e tyre" në ligjin nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme":

1. Struktura e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të jetë sipas skemës 1 bashkëlidhur.
2. Organika e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të jetë sipas skemës 2 bashkëlidhur.
3. Numri i punonjësve të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të jetë gjithsej 19 vetë.

4. Numri i zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në rrethe do të jetë 37, numri i punonjësve në to do të jetë 140 vetë.

5. Efektet financiare të përballohen nga buxheti aktual i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

6. Ndryshimet në këtë strukturë duhet të shoqërohen me argumentimet përkatëse të përballimit të kostos nga kosto lokale, burime të brendshme apo nga qarkullimi i personelit nga struktura të tjera të administratës publike pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

Skema nr.1

ZYRA QENDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME



Skema nr.2

ORGANIKA E ZYRËS QENDRORE TË REGJISTRIMIT
TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

KRYEREGJISTRUESI	1
Zv/ KRYEREGJISTRUESI	1
DREJTORIA TOPOGRAFIKE	3
Drejtori	1
Specialistë	2
DREJTORIA JURIDIKE	2
Drejtori	1
Specialist	1
DREJTORIA E POLITIKAVE TË TOKËS DHE E MARRËDHËNIEVE ME JASHTË	3
Drejtori	1
Specialistë	2
DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE	9
Drejtori	1
SEKTORI I FINANCËS	
Përgjegjësi i sektorit të financës (Financier)	1
Revizor	1
Arkëtare	1
SEKTORI I SHËRBIMEVE	
Përgjegjësi i sektorit të shërbimeve	1
Shofer	2
Pastrues	1
Roje	1
PUNONJËS GJITHSEJ NË ZYRËN QENDRORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME	19
PUNONJËS GJITHSEJ TË ZYRAVE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME NË RRETHE	140

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

V E N D I M
Nr.281, datë 9.5.1998

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.157, DATË 26.2.1998 "PËR FILLIMIN E PUNËS SË ZYRËS SË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME NË DISA RRETHE"

Në mbështetje të neneve 54 dhe 56 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.157, datë 26.2.1998, pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

"Zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat do të hapen gjatë vitit 1998, u akordohet një fond prej 6600 mijë lekësh për sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, 1000 mijë lekë për shpenzime dhe 3000 mijë lekë për investime.

Ky fond përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Numri i punonjësve për këto zyra është 43.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.553, datë 28.8.1998

PËR REGJISTRIMIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME TË SHOQËRIVE TREGTARE, TË KRIJUARA NGA TRANSFORMIMI I NDËRMARRJEVE SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 2 të ligjit nr.8237, datë 1.9.1997 "Për disa ndryshime në ligjin nr.7326, datë 20.4.1995 "Për transformimin i ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", ndryshuar me dekretin nr.1195, datë 14.8.1995, ligjin nr.8099, datë 28.3.1996, dekretin nr.1631, datë 1.11.1996, të neneve 192, 193 të Kodit Civil dhe të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme"", me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe të Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pasuritë e paluajtshme, pronë shtetërore, të vendosura si kontribut në natyrë në kapital themeltar të shoqërive tregtare, të krijuara nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore, në bazë të ligjit nr.7292, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme, si pasuri e këtyre shoqërive.

2. Regjistrimi i pasurive të paluajtshme të bëhet në bazë të urdhrit të Ministrit të Ekonomisë Publike dhe të Privatizimit. Ky urdhër, si rregull, duhet të përmbajë të dhënat për vlerën, kufijtë, sipërfaqen dhe vendndodhjen e pasurisë së paluajtshme, për të cilën kërkohet regjistrimi.

3. Bashkëlidhur urdhrit të lartpërmendur, të paraqiten për regjistrim në regjistrin e pasurive të paluajtshme, vendimi i gjykatës për regjistrim në regjistrin tregtar, bashkë me aktet me të cilat

krijohet shoqëria tregtare, si dhe planrilevimi i pasurisë së paluajtshme për të cilën kërkohet regjistrimi.

4. Kur një shoqëri tregtare disponon pasuri të paluajtshme në zona të ndryshme të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, regjistrimi i tyre bëhet pranë zyrës së regjistrimit të pasurisë së paluajtshme për të cilën kërkohet regjistrimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Fatos Nano

V E N D I M
Nr.596, datë 21.9.1998

PËR MBYLLJEN E ZYRAVE TË HIPOTEKAVE DHE PËR KALIMIN E VEPRIMTARISË SË TYRE NË ZYRAT E REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME

Në mbështetje të neneve 56 e 57 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Zyrat e hipotekës mbyllen dhe veprimtaria e tyre të realizohet nga zyra e regjistrimit të pasurive së paluajtshme të rretheve.

Zyrat e hipotekave hiqen nga struktura e Ministrisë së Drejtësisë, duke pakësuar organikën përkatëse.

Objektet, ndërtesat dhe mjediset pronë shtetërore, që kanë pasur në përdorim zyrat e hipotekave, mbeten në dispozicion të Ministrisë së Drejtësisë, për t'u përdorur si zyra të përmbarimit apo dhe për veprimtari të tjera të kësaj ministrie.

2. Ministria e Drejtësisë dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të marrin masa për transferimin e dokumenteve të zyrave të hipotekës, duke siguruar respektimin e rregullave për dorëzimin e tyre.

3. Në zbatim të këtij vendimi, Ministri i Drejtësisë, me urdhër të veçantë, përcakton:

3.1. punonjësit e hipotekave të cilët, sipas numrit të propozuar nga Kryeregjistruesi, do të vazhdojnë veprimtarinë pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme deri në përfundimin e regjistrimit fillestar, duke lidhur kontratë pune të kushtëzuar me afatin e mësipërm, përveç kur mbahen për plotësimin e vendeve vakante;

3.2. punonjësit e hipotekave, të cilët ndërpresin marrëdhëniet e punës për shkak të mbylljes së veprimtarisë;

3.3. destinacionin e mjeteve të punës që mbeten në dispozicion të Ministrisë së Drejtësisë;

3.4. mënyrën e veprimit me ndërtesat dhe mjediset e zyrave të hipotekave, që nuk janë pronë shtetërore.

4. Nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë pakësohet fondi i pagave dhe i shpenzimeve të tjera, të planifikuara për zyrat e hipotekave, për vitin 1998, në pjesën e papërdorur deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

Nga vlera e mësipërme në buxhetin e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme shtohet pjesa proporcionale, e cila i korrespondon numrit të punonjësve të hipotekave që do të aktivizohen me kontratë, ndërsa pjesa tjetër i kalon Buxhetit të Shtetit.

5. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.303, datë 16.4.1996, pika 2, nr.426, datë 17.6.1996, nr.676, datë 14.10.1996, nr.580, datë 22.12.1997, nr.174, datë 18.4.1995, pika 4, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Fatos Nano

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
  Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
13.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

14.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
15.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

Së shpejti në botim, përmbledhje në fushën e taksave dhe tatimeve

Doli nga shtypi më 8.7.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 100 lekë